



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.70/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afiete Sada anëtarë, me zyrtares e lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Prishtinë, paraqitur kundër G.I Listës Serbe, me seli në Graçanicë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në shenjat e trafikut, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Prishtinë, dhe Listës Serbe, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,200.00 (njëmijë dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 05.06.2017, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se gjatë vëzhgimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme, më datën 04.06.2017, në fshatin Prekoc të komunës së Artanës ishte vendosur poster i Listës Srbska në shenjën udhëzuese të komunikacionit.

Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, vendosja e materialit zgjedhor në shenjë publike të trafikut përbën veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre

Parashtuesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar.

Në përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2017, lidhur me ankesën e parashtuar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ku pretendohet se subjekti politik Lista Serbska ka vendosur postere në vendet publike (në shenja komunikacioni) ku nuk lejohet vendosja, theksuan se subjekti politik GISL e respekton Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Rregullën Zgjedhore nr.11/2013 dhe sipas kësaj të gjithë aktivistëve e tyre i ka njoftuar qartë me udhëzimet se në çfarë mënyre dhe ku lejohet të ekspozohen posteret politike gjatë fushatës zgjedhore mirëpo në përgjigje kanë shtuar se do të zhvilloje një procedurë të hetimit dhe vërtetimit nëse dikush nga aktivistët, nga mosdija, kanë vendosur postere në vendet ku nuk lejohet vendosja e tyre.

Me datë 06.06.2017 GI Lista Serbe i ka ndërmarr masat korrektuese dhe ka urdhëruar aktivistëve të saj që të largojnë të gjitha posteret nga vendet ku nuk lejohet vendosja e tyre, me çka është evituar parregullsia e vërejtur, e cila sipas tyre nuk ka qenë e qëllimshme.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se materiali zgjedhor i subjektit politik nga G.I Srbska Lista janë të vendosura në shenjat e trafikut konkretisht në shenjat udhëzuese të trafikut, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase G.I Srbska Lista kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti se materiali zgjedhor nga ky subjekt politik është vendosur në shenjat e trafikut. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se subjektit politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr materialin zgjedhor nga shenjat e trafikut - në vendin e palejuar, edhe pse nuk kanë ofruar asnjë foto si dëshmi që kanë bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.70/2017 më datën 07.06.2017.

Kryesuesi i Panelit  
Zyhdë Haziri



### ***Këshilla Juridike:***

*Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.*